



# Newsletter Bota e SIGAL UNIQA

Botimi për muajin shtator 2024

jetojmë më  
mirë së bashku

Sigurimi KASKO me SIGAL UNIQA

Merr një  
Ofertë



# PËRMBAJTJA

Portali ndërkombëtar: “SIGAL UNIQA” mbetet grupi më i madh i sigurimeve në Shqipëri

Viti i ri shkollor/ Urimi i CEO-s së “SIGAL UNIQA”: Fëmijët e ardhmja jonë, mësuesit udhërrëfyesit e tyre. Mos të mungojë vëmendja dhe kujdesi ndaj tyre

SIGAL UNIQA, mes Top 100 kompanive në Shqipëri/ E para në sigurime

SIGAL UNIQA mbetet më e madhja dhe më e besuara në tregun shqiptar të sigurimeve

Kampionët me kampionët/ Vizion bashkëpunimi KB Prishtina-SIGAL UNIQA

Për herë të parë në Shqipëri/ “SIGAL UNIQA” dhe “Rentout” sjellin FULL KASKO+AutoSOS me opion ditor

Raporti i BQK: SIGAL UNIQA mbetet lidere e sigurimeve në Kosovë

“UNIQA”, lidere në dy klasat më të gjera të sigurimeve në Maqedoninë e Veriut

Gamë e gjerë shërbimesh, nën një çati / UNIQA zgjeron rrjetin e saj mjekësor, shtohet edhe “Competence Center Health St. Stephan Wels”

Evropa nën ujë/ CEO i “UNIQA” zbret në terren: Ende dyshoni se duhet vepruar?

Fatkeqësitë natyrore, Brandstetter: T’i kthejmë qytetarët nga përfitues të lëmshës në partnerë të një kontrate ligjore

## Parimet dhe vlerat tona udhëzuese

### Klientët të parët

Ne jemi të fokusuar me vendosmëri në nevojat e klientëve tanë.

### Thjeshtësia

Ne veprojmë dhe mësojmë nga gabimet

### Përgjegjshmëria

Ne inkurajojmë njëri-tjetrin për të marrë përgjegjësi.

### Integriteti

Ne i mbajmë premtimet tona.

### Komuniteti

Ne bashkëpunojmë përtej kufijve të zakonshëm.



# jetojmë më mirë së bashku

Mbroni atë që mund  
të mbroni vetë

Sigurimi  
i Shtëpisë  
te SIGAL  
UNIQA





# rritemi më mirë së bashku

Ngjarjet kryesore



# Portali ndërkombëtar: “SIGAL UNIQA” mbetet grupi më i madh i sigurimeve në Shqipëri



Portali i specializuar për sigurimet, “Xprimm”, ka marrë në analizë raportin e fundit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF) mbi ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Sipas medias në fjalë, kompanitë shqiptare të sigurimeve shënuan prime bruto me vlerë 118.43 milionë euro, ose 14.12% më shumë në terma vjetorë.

Sigurimi i Jetës vazhdon të mbajë vetëm një peshë të vogël në portofolin e tregut, prej më pak se 9%, megjithëse PBB-ja për këtë segment u rrit me 21.4% (në euro). Si të tilla, klasat e sigurimeve jo-jetë mbeten dominuese.

Klasat e sigurimeve motorike – në veçanti sigurimi MTPL – mbetën jo vetëm segmentet e tregut me peshën më të madhe në portofol, por edhe dominuesit e tregut, duke siguruar rreth 80% të rritjes në terma absolutë.

“Në fakt, kjo situatë mund të shpjegohet të paktën pjesërisht nga sjellja e konsumatorëve

shqiptarë, të nxitur kryesisht drejt sigurimeve të detyrueshme”, shkruan ndër të tjera “Xprimm”.

Sa i përket dëmeve të paguara, “Xprimm” shkruan se: “Siguruesit shqiptarë kanë paguar dëme në vlerë prej 41.11 milionë euro, 32% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Krahas rritjes së kostove të riparimit, një kontribut të rëndësishëm në rritjen e shpenzimeve për dëme ka edhe numri i madh i aksidenteve në rrugët shqiptare. Sipas të dhënave të Institutit Shqiptar të Statistikave, 767 aksidente rrugore janë regjistruar në Shqipëri në gjysmën e parë të vitit 2024, me pasojë 976 të plagosur dhe 75 të vdekur”.

Por cilat janë kompanitë më të mëdha të sigurimeve në Shqipëri?

“Siguruesit më të mëdhenj në vend për sa i përket primeve të shkuara janë dy filialet e “UNIQA”-s austriake. SIGAL LIFE UNIQA mbetet siguruesi kryesor i jetës (40% e tregut), ndërsa SIGAL UNIQA mbetet e para në Sigurimet e Jo-jetës me 28% të tregut”, shkruan “Xprimm”.



# Viti i ri shkollor/ Urimi i CEO-s së “SIGAL UNIQA”: Fëmijët e ardhmja jonë, mësuesit udhërrëfyesit e tyre. Mos të mungojë vëmendja dhe kujdesi ndaj tyre



Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, përmes një mesazhi në rrjetet sociale, CEO i “SIGAL UNIQA Group Austria”, z.Avni Ponari uroi të gjithë nxënësit dhe mësuesit, duke cituar edhe një thënie të Nelson Mandelës, e cila tregon rëndësinë që ka arsimit për një komb.

Mesazhi i plotë i z.Ponari:

“Arsimimi është arma më e fuqishme të cilën mund ta përdorni për ta ndërruar botën“, Nelson Mandela

Në emrin tim dhe të kompanisë që drejtoj, “SIGAL UNIQA Group Austria”, i uroj të gjithë nxënësve ditën e parë të shkollës. Një vit shkollor sa më të mbarë, të suksesshëm dhe sa më të frytshëm.

Urime të përzemërta edhe për të gjithë armatën e mësuesve, me shpresën se puna, dëshira dhe pasioni i tyre për dijen të gjejë strehë në mendjen e nxënësve.

Urime edhe prindërve për një vit sa më të suksesshëm për fëmijët e tyre, duke i kujtuar që sakrificat e bërë për t'i mundësuar fëmijëve arsimim sa më cilësor, një ditë do t'ju shpërblehet.

Por urimi më i veçantë është padyshim për ata që sot për herë të parë do të ulen në bankat e shkollës duke nisur kështu një etapë të re të jetës së tyre.



Por ditë kaq të veçanta kanë nevojë edhe për disa këshilla:

Fëmijët janë e ardhmja jonë, ndërsa mësuesit udhërrëfyesit e tyre. Ndaj dhe vëmendja dhe kujdesi ndaj tyre nuk duhet të mungojnë kurrë.

Dhe kur flasim për përkujdesje shëndeti është elementi bazë. Unë jam i lumtur të pohoj se SIGAL UNIQA ka ditur gjithmonë që, përmes produkteve novatore, të dijë të ofrojë më të mirën e mundshme.

Edhe këtë vit të ri shkollor, SIGAL UNIQA vjen me dy paketa dedikuar pikërisht nxënësve, mësuesve por edhe prindërve: “Kartat e Kujdesit Shëndetësor”.



Paketa  
për të  
mitur

# KARTA E KUJDESIT SHËNDETËSOR

## MBULIMET

### Check Up

1 herë në vit  
(në klinika të paracaktuara)

#### Tiranë

✓ Gjak komplet, ✓ Urinë komplet, ✓ Glicemi esëll, ✓ Kolesterol, ✓ ALT, ✓ AST, ✓ Azotemi, ✓ Kreatinemi,  
✓ EKG, ✓ Konsultë Kardiologu, ✓ Echo me zgjedhje, ✓ Konsultë Patologu

#### Rrethe - KLIENTI DUHET TË ZGJEDHË 1 CHECK UP

✓ Check up 1  
Echo barku/ tiroide/ gjiri/ e indeve të buta  
Gjak komplet / Strishë Vaginale / Strishë  
Uretrale

✓ Check up 2  
Vizitë pediatri  
Gjak komplet  
Feçe parazitë

✓ Check up 3  
Feçe parazitë  
Koprokulturë

✓ Check up 4  
Gjak komplet  
Ferritinë

✓ Check up 5  
TSh  
Ca e jonizuar



Rrjetin Mjekësor Ekskluziv

Konsulta online me mjekun 24/7  
(Aplikacioni Teleshëndet)

Pa limit

Përfitime shtesë në klinika të paracaktuara  
Ekzaminime laboratorike dhe imazherike

Deri në 50% zbritje

Përfitime shtesë në klinika/spitale private  
të rrjetit SIGAL UNIQA

Deri 30% zbritje

Aksidente personale

Shuma e Siguaruar: 250,000 Lekë

Paafhtësi e përhershme

Deri në 100% të shumës së siguaruar

Shpenzime mjekësore si pasojë  
e një aksidenti

25,000 Lekë

Sigurim jete për prindin

100% e shumës së siguaruar

**5,000** Lekë/vit  
për person



# SIGAL UNIQA, mes Top 100 kompanive në Shqipëri/ E para në sigurime

SIGAL UNIQA Group Austria vazhdon të jetë jo vetëm kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve por edhe një mes Top 100 kompanive në Shqipëri.

Sipas rënditjes së revistës “Monitor” për Top 200 kompanitë më të mëdha në vend për vitin 2023, SIGAL UNIQA rënditet në vendin e 67-të, me një rritje prej 7 vendesh krahasuar me një vit më parë.



2023	2022	Subjekti	Aktiviteti	2023	2022	Ndryshimi	
29	53	21	BANKA OTP ALBANIA	Ndërmëtimi monetar	11,1	7,2	53,1
30	46	16	GJOKA KONSTRUKSION	NDËRTIMI - Punime inxhinjerie	10,8	8,0	34,7
31	35	4	EDUART 2010	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, jive dhe duhanit	10,6	10,1	4,9
32	7	25	ENER TRADE	Tregtia e energjisë elektrike	10,4	42,7	-75,6
33	37	4	TOBACCO HOLDING GROUP	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, jive dhe duhanit	10,4	9,4	10,8
34	44	10	TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK	Shërbime të lufurave me transportin ajror	10,1	8,3	21,9
35	32	3	OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMT OST	Transmetimi i energjisë elektrike	10,1	10,9	-7
36	30	6	SHJAKU	NDËRTIMI Punime inxhinjerie	10,0	11,4	-12
37	45	8	AGRO BLEND GROUP	Tregtia me shumicë e lëndëve të para bujqësore dhe kafshëve të gjuar	9,7	8,2	17,1
38	21	17	ERDOL	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse	9,6	15,7	-38,7
39	39	-	GENER 2	NDËRTIMI - Punime inxhinjerie	9,4	8,7	8,2
40	57	17	INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA	Ndërmëtimi monetar	9,3	8,8	37,5
41	42	1	MARKETING & DISTRIBUTION	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, jive dhe duhanit	9,0	8,5	6,6
42	43	1	NEFTUN	Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtetëse	8,4	8,3	1,2
43	15	28	ALBICROMI	Mjeteve e mineralëve të çmimit metalor	8,2	18,5	-56,1
44	41	3	SKENDRI G	Tregtia me shumicë e karburantit	7,9	8,5	-6,2
45	58	11	CFO PHARMA	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë	7,4	7,2	3,9
46	51	5	E. I. W.	Prishja dhe përpunimi i mishit dhe produkteve me bazë mish	7,4	7,5	-1,9
47	10	37	TENET	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse	7,3	8,8	-14,1
48	78	28	SHOQËRI E TRAJESHTË INTEKAR - ASL	NDËRTIMI - Punime inxhinjerie	7,3	5,3	37,8
49	49	-	BEGA CENTER SRS	Tregtia me shumicë e karburantit	7,2	7,8	-6,7
50	98	18	GREEN COAST	Ndërtimi i ndërtesave, Punime inxhinjerie	7,1	5,8	25,8

2023	2022	Subjekti	Aktiviteti	2023	2022	Ndryshimi	
67	74	7	SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA	Aktiviteti sigurues dhe të fondëve të pensioneve	5,6	5,4	3,9
68	78	11	LC WAKKI RETAIL AL SH.P.K	Tregtia me shumicë e tekstileve në dyqane të specializuara	5,6	5,1	8,8
69	64	5	EX FIS	Tregtia me shumicë e karburantit	5,5	5,8	-4,5
70	80	10	AIR ALBANIA	Transporti ajror pasagjerëve	5,5	5,0	10,0
71	60	11	LARTI - SHPK	Tregtimi i materialeve të ndërtimit	5,4	6,2	-11,5
72	68	4	AMERICAN HOSPITAL	Aktiviteti të spitalit	5,4	5,5	-2,3
73	58	15	KONIA	Tregtia me shumicë e mbeturave dhe sirizit	5,4	6,8	-18,7
74	74	4	BRUNES	Tregtia e materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidroantare	5,4	5,2	2,7
75	94	18	UNION BANK SHA	Ndërmëtimi monetar	5,4	4,4	22,8
76	81	5	BALEFIN CONSTRUCTION	Ndërtimi i ndërtesave, Punime inxhinjerie	5,1	4,9	3,7
77	85	8	REJDI FARMA	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë	5,1	4,8	9,9
78	90	21	ALGLOBAL OIL	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse	5,0	4,1	23,3
79	88	9	DELTA PHARMA - AL	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë	4,9	4,8	5,9
80	96	16	4 A.M	Instalime elektrike	4,7	4,2	12,3
81	101	28	GJURJURA	NDËRTIMI - Punime inxhinjerie	4,7	3,9	21,9
82	158	76	ISM MARKETING 2022	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, jive dhe duhanit	4,7	2,8	68,5
83	141	59	PORSCHE ALBANIA SH.P.K	Tregtia e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit	4,6	3,0	53,5
84	82	22	ALB - STAR	NDËRTIMI - Punime inxhinjerie	4,5	6,5	-30,9
85	114	29	R.B.H. BELINE	Tregtia me shumicë e karburantit	4,5	3,5	30,1
86	90	4	LËSJEJELËS KANALIZIME TIRANE	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	4,5	4,7	-4,6
87	81	26	RAFAEL & CO	Ndërtimi i ndërtesave, Punime inxhinjerie, hoteleri	4,4	6,1	-27,3
88	82	4	FERRA & C2	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, jive dhe duhanit	4,3	4,8	-9,8
89	129	48	EUROPE RÖL EXPORT	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse	4,3	3,2	32,8
90	142	52	SEWS CASINO ALBANIA	Prishja e pajisjeve të mjeteve të transportit	4,2	3,0	40,6
91	95	4	CONAD ALBANIA	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore në dyqane të specializuara	4,1	4,4	-5,3
92	52	40	EVEREST	Prishja e aluminit	4,0	7,5	-45,8
93	104	11	ALBANIA MOTOR COMPANY	Tregtia e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit	4,0	3,8	6,7
94	111	17	CONAD FOOD TRADE	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, jive dhe duhanit	3,9	3,5	12,0
95	98	3	ALBAELECTRICA	Instalime elektrike	3,9	4,1	-5,9
96	109	13	ITD SH.P.K	Tregtia me shumicë e kompjuterave	3,9	3,5	9,9
97	107	18	DAST DELTA ADHESIVE STRUCTURAL TECH	Tregtia e materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidroantare	3,9	3,6	8,1
98	108	10	PERJËJ & SHERB, TRANS, RRUGË**	Shërbime të lufurave me transportin rrugor	3,9	3,6	8,3
99	163	64	DIAMBE	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore në dyqane të specializuara	3,8	2,7	40,2
100	105	5	KLODI SRLA	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse	3,8	3,7	4,7


Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe teksa kompania e sigurimeve ofron produktet më novatore, është pranë klientëve kur ata kanë nevojë, respekton çdo kontratë konform ligjit, lidere në pagesat e drejtpërdrejta të dëmeve, ofertat e herëpashershme, mundësia që çdokush të sigurojë pronën, shëndetin apo automjetin pavarësisht të ardhurave që ka dhe të qenurit pjesë e shoqërive ku operon përmes nismave, aktiviteteve dhe sponsorizimeve të vazhdueshme.

“SIGAL UNIQA Group Austria” u themelua në Tiranë në shkurtin e vitit 1999 dhe sot pas më shumë se 25 vjetësh është një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Ajo operon suksesshëm në të trija shtetet përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurime Jo-Jetë, 3 Sigurime Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni Privat.

Kompani e standarteve evropiane

# SIGAL UNIQA mbetet më e madhja dhe më e besuara në tregun shqiptar të sigurimeve



SIGAL UNIQA Group Austria vazhdon të jetë kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri.

Sipas raportit të AMF, mbi ecurinë e tregut të sigurimeve për periudhën janar-gusht 2024, rezulton se SIGAL UNIQA mbetet numri 1 si në Sigurimet e Jo-Jetës, klasa më e madhe e sigurimeve ku operojnë 8 kompani, ashtu edhe në Sigurimet e Jetës.

SIGAL UNIQA mbetet më e madhja në Sigurimet Motorike, të Pronës e të Shëndetit duke ruajtur dhe zgjeruar në disa produkte pozicionin e saj në treg. Edhe sa i përket ndarjes në sigurime të

detyrueshme dhe vullnetare, SIGAL UNIQA mbetet kompania me pjesën më të madhe të tregut ku operojnë 8 kompani.

Produktet më novatore në treg, të qënurit pranë klientëve kur ata kanë nevojë, respektimi i çdo kontratë konform ligjit, lidere në pagesat e drejtpërdrejta të dëmeve, blerja online e çdo produkti dhe shërbimi, ofertat e herëpashershme, mundësia që çdokush të sigurojë pronën, shëndetin apo automjetin pavarësisht të ardhurave që ka e bëjnë SIGAL UNIQA-n një kompani të standarteve evropiane dhe më të madhen në Shqipëri prej më shumë se çerekshkulli tashmë.



# Kampionët me kampionët/ Vijn bashkëpunimi KB Prishtina-SIGAL UNIQA

Klubi i Basketbollit Prishtina dhe kompania e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria vazhdojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Kryetari i klubit Blerand Stavileci tha gjatë konferencës për media se, bashkëpunimi me SIGAL UNIQA e ka ndihmuar Prishtinën që ta vazhdojë rrugën e sukseseve dhe fitimin e trofeve të shumtë.

Ai shtoi se për 21 vjet bashkëpunim këto dy brende kanë qenë shembull i bashkëpunimit edhe për klubet tjera në Kosovë, ndërsa shtoi se CEO i SIGAL UNIQA, Avni Ponari ka qenë gjithmonë afër klubit duke e mbështetur atë në situata të mira por edhe të vështira.

Nga ana tjetër, Avni Ponari theksoi se këto dy brende janë rritur duke shënuar suksese të përbashkëta dhe duke arritur trofe të shumtë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Ai shtoi se ndihet krenar me bashkëpunimin e KB Prishtinës gjatë gjithë këtyre viteve dhe është i lumtur që do të vazhdojë ta mbështesë këtë klub.

**SIGAL UNIQA, GJITHMONË PRANË SPORTIT**

SIGAL UNIQA ka qenë gjithmonë një ogur i mirë për sportin dhe sportistët.

Në SIGAL UNIQA besojnë fort se Sporti është mjeti më efikas i edukimit, i argëtimit, i parandalimit të sëmundjeve, dhe forcimit të marrëdhënieve sociale.



# Për herë të parë në Shqipëri/ “SIGAL UNIQA” dhe “Rentout” sjellin FULL KASKO+AutoSOS me opsion ditor



Doni që çdo udhëtim i juaji brenda Shqipërisë të jetë i sigurtë në çdo sekondë?

Mos u shqetësoni! SIGAL UNIQA di të japë gjithmonë zgjidhjet perfekte.

Kompania lider e sigurimeve në Shqipëri, e njohur për risitë dhe inovacionet që sjell vazhdimisht, ofron tashmë një supermundësi edhe për ata që zgjedhin të udhëtojnë jo me automjetet e tyre.

Cilido që merr një makinë me qira përmes aplikacionit “RentOut” dhe do të shijojë udhëtimin pa u shqetësuar për të papriturat e rrugës, SIGAL UNIQA mundëson policën e sigurimit Full KASKO dhe shërbimin e Asistencës Rrugore “AutoSOS” edhe me opsion ditor.

Me pak fjalë, për aq kohë sa ti përdor makinën e marrë me qira, aq edhe do të paguash për sigurimin e plotë të saj.

Çfarë mbulin Sigurimi Full KASKO?

- Dëmtimet aksidentale
- Thyerja e xhamave
- Zjarr, rrufe, eksplozion
- Katastrofa natyrore
- Dëmtim në parkim nga një mjet tjetër

Çfarë ofron Asistenca Rrugore “SIGAL UNIQA AutoSOS”?

- Qendër suporti 24 orë të ditës, 7 ditë të javës
- Riparim në vend i automjetit
- Shërbimi karroatreci
- Zëvendësim mjeti
- Parkim
- Taksi

Shijoni çdo udhëtim tuajin me SIGAL UNIQA dhe “Rentout”, pa u shqetësuar se çfarë surprizash mund tu sjellë rruga

Për më shumë informacione, shkruani në:  
[rentout.ai](http://rentout.ai)




Besueshmëri, përgjegjësi, shërbim ekselent ndaj klientit

## Raporti i BQK: SIGAL UNIQA mbetet lidere e sigurimeve në Kosovë



BQK - Buletini statistikor  
Pozicioni në treg Nr. 1

Primet e Shkruara Bruto nga  
Kompanitë e Sigurimit të Jo-Jetës



SIGAL UNIQA Group AUSTRIA vazhdon të jetë lider në tregun e sigurimeve edhe në Kosovë.

Sipas raportit më të fundit nga BQK (Banka Qendrore e Kosovës), SIGAL UNIQA kryeson tregun e sigurimeve të Jo-Jetës sa i përket primeve të shkruara në periudhën janar-gusht 2024.

Nga 10 kompani që operojnë në treg ajo zë 14.5% të totalit.

Nëse për të njëjtën periudhë të një viti më parë SIGAL UNIQA Kosova numëronte 13,2 milionë euro prime, këtë vit shifra ka shkuar në mbi 15.6 milionë euro çka tregon edhe besimin në rritje ndaj kompanisë.

Pa harruar që, rreth 9 milionë euro prime i përkasin sigurimeve vullnetare.

### SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA – Kosova u themelua në vitin 2003.

Sot, pas më shumë se 20 vjetësh, ajo mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Kosovë.

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë ka qenë edhe një nga kontribuesit kryesor të jetës ekonomiko-financiare të vendit. Gjatë këtyre viteve ajo jo vetëm që ka kryer mbi 12 milionë euro investime por ka qenë suportuese e Sportit, Artit, Kulturës e shumë fushave të tjera.

Ndaj sot, ajo është simbol i besueshmërisë, përgjegjësisë dhe shërbimit ekselent ndaj klientit.

Web: [www.sigal-ks.com](http://www.sigal-ks.com)

Tel: +383 38 240 241

# “UNIQA”, lidere në dy klasat më të gjera të sigurimeve në Maqedoninë e Veriut

“UNIQA” vazhdon të jetë një ndër emrat më të mëdhenj e të besuar të sigurimeve jo vetëm në Shqipëri e në Kosovë, por edhe në Maqedoninë e Veriut.


Sipas raportit të fundit të ASO (Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve) mbi ecurinë e tregut të sigurimeve në Maqedoninë e Veriut gjatë muajit gusht 2024, “UNIQA AD Shkup”, përveç rritjes në të gjitha klasat e sigurimeve, rezulton kompania me besimin më të madh në sigurimin e detyrueshëm të automjeteve (TPL) dhe Sigurimin e Pasurisë.

Nga 11 kompani që operojnë në tregun e sigurimeve të jo-jetës, “UNIQA” zë 33% në Sigurimin e Pasurisë dhe 15% në Sigurimin TPL.

## Sigurimi i Pasurisë (33%)



## Sigurimi i Detyrueshëm i Automjeteve, TPL (15%)



Kompania e sigurimeve UNIQA AD Shkup është pjesë e grupit më të madh të sigurimeve në rajon “SIGAL UNIQA” dhe grupit austriak “UNIQA INSURANCE GROUP”.

Ajo operon në tregun maqedonas të sigurimeve prej 19 vitesh tashmë duke shënuar suksese të jashtëzakonshme. Shërbimi profesional ndal klientit, produkte më të mira dhe novatore dhe pagimi në kohë i dëmeve e bëjnë atë një emër të besueshëm për qytetarët dhe bizneset në Maqedoninë e Veriut.



# Gamë e gjerë shërbimesh, nën një çati

UNIQA zgjeron rrjetin e saj mjekësor, shtohet edhe “Competence Center Health St. Stephan Wels”

Rreth 1.4 milionë njerëz në Austri i besojnë UNIQA-s shëndetin e tyre, duke e bërë kompaninë kompaninë më të madhe sa i përket sigurimit shëndetësor.

“Në mënyrë që klientët të marrin mbështetje optimale, ne po ndërtojmë një rrjet partnerësh në mbarë Austrinë. Ai përbëhet nga ofrues të ndryshëm të shërbimeve shëndetësore – mbi të gjitha, mjekë të zgjedhur”, thotë René Knapp, Anëtar Bordi për Sigurimet Personale në UNIQA Insurance Group AG.

Në zgjerimin e rrjetit “LARA”, UNIQA tashmë po mbështetet gjithnjë e më shumë në bashkëpunimin me qendrat mjekësore.

“Në qendrat tona partnere mjekësore, një gamë e gjerë shërbimesh mjekësore ofrohet shpejt dhe lehtë – të gjitha nën një çati. Në terma konkretë, kjo do të thotë: kujdes mjekësor me takime të shpejta me mjekët tanë, kujdes fillestar i shpejtë jashtë orarit normal të punës, diagnostikim gjithëpërfshirës, ekzaminime të detajuara parandaluese me UNIQA VitalCheck apo edhe kontrole të shkencës sportive”, shpjegon Knapp.

“Competence Center Health St. Stephan Wels”, qendra e re partnere mjekësore UNIQA.

Deri më sot, UNIQA u ka ofruar klientëve të saj katër Qendra Mjekësore Partnere në të gjithë Austrinë (dy në Vjenë, një në Styria dhe një në Vorarlberg). Ndërsa tashmë, Qendra e Kompetencës Shëndetësore St. Stephan Wels është qendra e parë partnere mjekësore UNIQA në Austrinë e Epërme.



“Jam i kënaqur që arritëm bashkëpunimin me Qendrën Shëndetësore të Kompetencës Shën Stefan në Wels si qendrën e parë partnere mjekësore UNIQA në Austrinë e Epërme. Kjo na lejon të forcojmë vendndodhjen në Austrinë e Epërme dhe të zgjerojmë më tej ofertën mjekësore për klientët tanë”, thekson Alexander Schinnerl, Drejtor i UNIQA në Austrinë e Epërme.

Me mbi 40 mjekë dhe terapistë nga disiplina të ndryshme, kjo qendër ofron shërbime gjithëpërfshirëse diagnostikuese dhe terapeutike.

Si një partner i kujdesit akut, kjo qendër ofron ndihmë të shpejtë mjekësore edhe jashtë orarit të punës, në fundjavë dhe në ditë festash.

“Ekipi ynë prej më shumë se 100 punonjësish ofron një ofertë mjekësore gjithëpërfshirëse, ndërdisiplinore në një sipërfaqe prej 6,500 m<sup>2</sup>. E shohim këtë zhvillim të mëtijshëm si konfirmim të bashkëpunimit të mëparshëm të suksesshëm me UNIQA, i cili vlerësohet nga shumë klientë”, thotë Dr. Andreas Artmann, koordinator mjekësor i Qendrës së Kompetencës Shëndetësore St. Stephan Wels.

“Më shumë shërbime të kujdesit shëndetësor nga një burim i vetëm”, Brandstetter: Po investojmë rreth 50 milionë euro çdo vit

Në një intervistë të mëparshme për median austriake “Trend”, CEO i “UNIQA Insurance Group”, Andreas Brandstetter, do të fliste ndër të tjera mbi investimet që grupi që ai kryeson po bën kryesisht në shëndetësi.

Sipas Brandstetter, në sajë të investimeve të rëndësishme, rreth 50 milionë euro në vit, UNIQA u mundëson 4 milionë klientëve të saj në Austri dhe 17 milionë në Europë, mundësinë e marrjes së shërbimeve shëndetësore nga një burim i vetëm.


“Po zhvillojmë shërbime për njerëz të shëndetshëm, pra për parandalim. Dy shembuj të kësaj janë ekzaminimet parandaluese gjithnjë e më të rëndësishme ose testet në shtëpi që sapo përmendëm. Dhe nga ana tjetër investojmë shumë edhe në “riparime” mjekësore të shpejta dhe të klasit të parë.

Kjo është arsyeja pse po investojmë miliona euro për vitet e ardhshme me qëllim zgjerimin e rrjetit mjekësor.

Shifrat tregojnë se ne po investojmë shumë për klientët tanë, rreth 50 milionë euro në vit”, do të shprehej ndër të tjera CEO i “UNIQA”.

## **Evropa nën ujë/CEO i “UNIQA” zbrit në terren: Ende dyshoni se duhet vepruar?**

Teksa një pjesë e mirë e Evropës Qëndrore dhe Lindore janë përfshirë nga përmbytje masive duke lënë pas dëme të mëdha në njerëz, prona dhe infrastrukturë, vjen edhe një mesazh nga CEO i “UNIQA Insurance Group”, një ndër kompanitë më të mëdha të sigurimeve në kontinent.



Teksa një pjesë e mirë e Evropës Qëndrore dhe Lindore janë përfshirë nga përmbytje masive duke lënë pas dëme të mëdha në njerëz, prona dhe infrastrukturë, vjen edhe një mesazh nga CEO i “UNIQA Insurance Group”, një ndër kompanitë më të mëdha të sigurimeve në kontinent.

Andreas Brandstetter, grupi i cili drejton është aktiv në të gjitha shtetet e prekura, ka vizituar Kamptal në Austri nga ku jep edhe një mesazh të fortë mbi ndryshimet klimatike dhe rreziqet që na kanosen.

“Ky është Kamptal, vendi ku jam rritur. Këtu dhe në shumë pjesë të Austrisë aktualisht është një situatë katastrofike.

Pikat e forta janë njerëzit dhe gatishmëria e madhe për të ndihmuar të shumë, shpeshherë edhe si vullnetarë.

Sot ne të gjithë jemi me të gjitha forcat me të prekurit ndërsa nesër të gjithë do të angazhohemi – në luftën kundër ndryshimeve klimatike.

Shkenca është shumë e qartë: Për çdo gradë Celsius shë, ajri mund të thithë rreth shtatë për qind më shumë lagështi. Dhe kjo do të thotë shi. Shumë shi i dendur. Ende dyshoni se duhet të veprjmë?”





## Fatkeqësitë natyrore, Brandstetter: T'i kthejmë qytetarët nga përfitues të lëmoshës në partnerë të një kontrate ligjore

Pak ditë pasi Evropa Qendrore u godit nga përmbytje katastrofale, me viktime në njerëz dhe dëme materiale miliarda euro, CEO i "UNIQA Insurance Group" Andreas Brandstetter, në një intervistë për median austriake "Salzburger Nachrichten", shprehet se lëvrimi i fondit të emergjencës, i cili mbulon vetëm 20-30% të dëmit, është një spektakël i pakëndshëm.

Pjesë nga intervista:

SN: Refuzimi i politikanëve për sigurimin ndaj fatkeqësive natyrore është vetëm një shembull i mungesës së vullnetit për të trajtuar reformat e nevojshme. Është loja e njohur pas një fatkeqësie. Politikanët

pretojnë ndihmë përmes fondit të fatkeqësive – por kjo mbulon vetëm një pjesë të dëmit. A ju shqetëson kjo, veçanërisht pasi siguruesit kanë thënë për shumë vite se ka mënyra të tjera për t'u marrë me të?

Andreas Brandstetter: Si dikush që vjen nga rajoni i prekur, Kamptal, dhe që sheh vuajtjet e njerëzve atje, është e vështirë për të kontrolluar emocionet. Por ne e shohim këtë vetëm si një simptomë të mosgatishmërisë së politikanëve për të reformuar. Mund të flasim gjithashtu për arsimin, migrimin, shoqërinë në plakje, sistemin shëndetësor, ose, siç po flasim tani për përgatitjet për fatkeqësitë natyrore.

SN: Çfarë duhet bërë?

Andreas Brandstetter: Prej dekadash industria e sigurimeve ka paralajmëruar një rritje të ngjarjeve të tilla, të cilat po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. Sipas Swiss Re, vendi ynë (Austria) është i katërt në botë për sa i përket dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, të matura si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto. 20 vjet më

parë, dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në Austri arrinin nga 300 deri në 400 milionë euro në vit; tani jemi në mbi 1 miliard euro – pa përfshirë këto të këtij viti.

Prej dekadash ne u propozojmë politikanëve një model i cili ka rezultuar i suksesshëm në vende të tjera, si në Belgjikë. Kjo do të na mundësonte t'i kthejmë njerëzit nga pozita e përfituesve të lëmshës në partnerë në një kontratë ligjore. Ata nuk do të ishin më në mëshirën e një guvernatori rajonal që do t'u rimbursonte 20 deri në 30% të dëmit nga fondi i fatkeqësive. Ky është një spektakël jo dinjitoz për të cilin nuk kam asnjë kuptim. Për shtatë, tetë, nëntë euro në muaj të përfshira në sigurimin nga zjarri, do të kishte një mbulim 100% të vlerës së dëmit.

SN: Pse politika nuk e trajton këtë?

Andreas Brandstetter: Unë u jap meritë të gjithë politikanëve që u përpoqën dhe kam respekt për të gjithë ata që janë aktivë politikisht.

Problemet e përmendura janë komplekse. Por ato mund të zgjidhen nëse duam. Pra, si të përballemi me rreziqet e fatkeqësive natyrore? Për shkak të shkallës, është e mundur vetëm me numrin e madh të të siguruarve, prandaj duhet parë propozimi ynë për sigurimin nga zjarri.

Austria do të vazhdojë të ndikohet shumë nga ndryshimet klimatike në të ardhmen. Të gjitha modelet që kemi e tregojnë këtë shumë qartë. Dhe ne kemi vite që u themi politikanëve për atë që na pret por po mohohet dhe kjo na zemëron. Nëse politikanët nuk dorëzohen, a nuk do të jenë më të sigureshme rreziqet?

.Aq më tepër që ne duhet t'u paguajmë çmime në rritje edhe risiguresve. Ata po shikojnë se çfarë po ndodh në Austri. Ne do të përdorim negociatat e ardhshme të qeverisë për të vënë sërish në tryezë propozimet tona. Ndoshta ajo që po përjetojmë tani është thirrja e zgjimit që ishte e nevojshme për të joshur ata që janë përgjegjës për politikën nga zona e tyre e rehatisë.

SN: Ju theksoni se siguresit janë të përgatitur të investojnë shumë para në luftën kundër ndryshimeve klimatike.

Andreas Brandstetter: Ne e diskutuam këtë me qeverinë. Vetëm siguresit në Austri menaxhojnë 100 miliardë euro dhe në të gjithë Evropën janë 11 trilionë euro. Vendi ku investojmë është vendimtar dhe do të përcaktojë gjithashtu nëse transformimi i gjelbër do të ketë sukses në Evropë. Familjet austriake kanë 850 miliardë euro asete financiare.

Evropa Qendrore përjetoj javën e shkuar përmbytjet e saj më të këqija në dekada, me vlerësimet e humbjeve ekonomike që tejkalojnë 1 miliard euro.

Vende si Austria, Republika Çeke, Polonia dhe Rumania ishin ndër vendet më të goditura nga stuhia Boris, që ka çuar në humbje katastrofike ndërprerje të bizneseve, ndërprerje të tregtisë ndërkufitare dhe 24 viktima në njerëz.





# Kujdesi më i mirë shëndetësor është në dorën tuaj

Sigurimi Anti-Tumor në  
SIGAL UNIQA ofron mbulim  
financiar të menjëhershëm  
në rast diagnostifikimi me  
një tumor malinj ose  
beninj në kokë.

**Përfito  
Mamografi  
Falas**





COPYRIGHT SIGAL UNQA 2024

*Përmbajtja e këtij newsletter dhe të gjitha të drejtat e saj i përkasin kompanisë së sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria dhe përdorimi nga të tretë, pa autorizimin e SIGAL UNIQA nuk është e lejuar. Shpërndarja e këtij newsletter mund të bëhet vetëm nëpërmjet kanaleve zyrtare të kompanisë.*